



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 1 gusht 2017

Ref. Nr: 153/01 B

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 82, 21 tetor 2010), neneve 5 dhe 24 të Ligjit nr. 04/L032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17/16, shtator 2011), dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet vazhdimi i procesit të pilotimit për klasën e pestë (5) në shkollat që kanë filluar me pilotim në vitin shkollor 2013/2014 në Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 2017/2018.
2. Aprovohet vazhdimi i procesit të pilotimit për klasën e katër (4) dhe klasën e nëntë (9) në shkollat që kanë filluar me pilotim në vitin shkollor 2014/2015 në Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 2017/2018.
3. Aprovohet vazhdimi i procesit të pilotimit për klasën e tretë (3), klasën e tetë (8) dhe klasën e njëmbëdhjetë (11) në shkollat që kanë filluar me pilotim pas rishikimit të KKK-së dhe hartimit të KB-ve në vitin shkollor 2015/2016 në Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 2017/2018.
4. Të gjitha Drejtoritë Komunale për Arsim dhe shkollat të cilat janë në pilotim bëjnë përgaditjet për vazhdimin e procesit të pilotimit në vitin shkollor 2017/2018.
5. Përgaditjet përfshijnë:

- 5.1. Informimin dhe senzibilizimin e komunitetit arsimor të shkollës me programe të reja lëndore;
  - 5.2. Riorganizimin e organeve profesionale të shkollës;
  - 5.3. Përgaditjet e planit vjetor, periodik, mujor, javor dhe ditor, në zbatim të programit mësimor për klasë.
6. Me vazhdimin e procesit të pilotimit sipas KKK-së dhe KB-ve, shfuqizohen dokumentet paraprake.
  7. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamentet e Divizionet përgjegjëse të MASHT-it për zbatimin e këtij vendimi.
  8. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetim

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë, kërkesës me nr. 8/2-2682 të dt. 26.07.2017 dhe pas realizimit të zbatimit të vendimit për nënshkrim dhe finalizimin e dokumentit, i cili proces ka qenë rezultat i zbatimit të programit mësimor në 95 shkolla të Kosovës, nga koordinatorët e MASHT-it, koordinatorët e DKA-ve për kurrikula, koordinatorët e cilësisë në shkolla, prindërit, trajnerët, nga projekti mbështetës i GIZ, nga vizita e shkollave pilotuese dhe nga raportet të propozimeve të hartimit të programeve lëndore, u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Arsim BAJRAMI, ministër  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

#### Iu dërgohet:

- Sekretarit të përgjithshëm, MASHT;
- Departamentit për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar/MASHT;
- Departamentit për Politikën e Arsimit Parauniversitar/MASHT;
- Departamentit të Inspektimit të Arsimit/MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Arsimin Parauniversitar/MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve/MASHT;
- Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve/MASHT;
- Divizionit për Planprogrameve dhe Teksteve Shkollore/MASHT;
- Drejtorive Komunale të Arsimit
- Arkivit/MASHT.